# DËSHMI ARKIVI

**A-445704**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Marr armë nga Sudani”/ Çfarë fshihet pas përgjimit të Ron Yeffet? Industria sudaneze nën sanksione nga SHBA-BE, Timak Defence duhej të humbiste licencën |
| ADRESA | `https://dosja.al/politike/marr-arme-nga-sudani-fare-fshihet-pas-pergjimit-te-ron-yeffet-industria-i514232` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 10:44:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 10:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `69c9733c1197d2cd94d4e6ce107718e940738e2b78251ba97551bd979e787536` |
| TEKSTI | `178af3904851c4adf6cf8429c6b5047fd70a151d6a119cf210168d46a0fb8b51` |
| PAMJA | `d3062ec48d99f0616c31d79333f1865c19a287a72b830f747e2475b4fd4f8283` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b6ee46d1225ace1f8b55584b068873f93520beeab2d68217b7938e17d3b765d7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b6ee46d1225ace1f8b55584b068873f93520beeab2d68217b7938e17d3b765d7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

1 ORE ME PARE
**Rekursi i Veliajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Veliaj mbetet në burg**

16 ORE ME PARE
**107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion**

17 ORE ME PARE
**Më 16 shtator jepet vendimi për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes**

22 ORE ME PARE
**"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!**

Politike

# "Marr armë nga Sudani"/ Çfarë fshihet pas përgjimit të Ron Yeffet? Industria sudaneze nën sanksione nga SHBA-BE, Timak Defence duhej të humbiste licencën

Dosja.al, ka bërë një kërkim ku thuhet se strukturat kryesore të Sudanit për armatime janë Defense Industries System (DIS) dhe GIAD, të cilat janë objekt sanksionesh nga SHBA-ja, BE-ja si dhe OKB-ja. Të dyja këto kompani janë të lidhura ngushtë me Forcat e Armatosura Sudaneze, të cilat janë në konflikt të hapur në Sudan.



15 Shtator 2026, 12:00
Nga Izmir Akulli




Ron Yeffet

Audio-përgjimi i Ron Yeffet i publikuar nga ish-zv/kryeministri Arben Ahmetaj ka nxjerr në pah një skandal në Shqipëri se si janë kontrolluar dhe licencuar aktivitetet e kompanive që operojnë në industrinë e mbrojtjes. Ron Yeffet është biznesmeni amerikano-izraelit, i përshkruar si i afërt me kryeministrin Edi Rama, i cili që nga prilli 2025 është përfshirë në industrinë e armatimit në Shqipëri.

Ai mban 49% të aksioneve të kompanisë "Timak", e cila me kompaninë shtetërore "Kayo" ka krijuar "Timak Defence" për prodhim/përshtatje automjetesh ushtarake dhe sisteme armatimi. Por Yeffet ka pranuar me gojën e tij në audio-përgjim se armët i merr nga Sudani dhe më pas i paketon në vendin tonë.

*"Qeveria e ka pajtuar për të gjitha gjërat e këqija që duhet të bëhen,"* ka thënë Yeffet në përgjim.

**Por si vijnë armët nga Sudani? Kush i prodhon?**

**Dosja.al** ka bërë një kërkim ku thuhet se strukturat kryesore të Sudanit për armatime janë Defense Industries

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:17
Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:15
FOTO/ Zendaya, Selena Gomez dhe yjet e Hollywood-it shkëlqejnë në tapetin blu të Emmy Awards

System (DIS) dhe GIAD, të cilat janë objekt sanksionesh nga SHBA-ja, BE-ja si dhe OKB-ja. Të dyja këto kompani janë të lidhura ngushtë me Forcat e Armatosura Sudaneze, të cilat janë në konflikt të hapur në Sudan.

**Çfarë janë DIS dhe GIAD?**

DIS, më parë e njohur si Military Industry Corporation (MIC), është konglomerati kryesor i industrisë ushtarake të Sudanit. Struktura prodhon armë, municione dhe pajisje ushtarake dhe është e lidhur drejtpërdrejt me Forcat e Armatosura të Sudanit (SAF). DIS është vendosur nën sanksione nga SHBA-ja dhe është përfshirë në masa kufizuese edhe nga partnerë të tjerë perëndimorë.

GIAD është një nga grupet më të mëdha industriale të Sudanit dhe përfshin kompani që prodhojnë automjete, pajisje dhe materiale me përdorim ushtarak. Grupi ka lidhje të ngushta me industrinë e mbrojtjes sudaneze dhe me strukturat e SAF-it. GIAD është gjithashtu subjekt i sanksioneve amerikane, çka e bën veçanërisht të ndjeshme çdo marrëdhënie tregtare që lidhet me furnizimin me armë apo pajisje ushtarake.

**A lejohet eksportimi i armëve nga Sudani?**

Përgjigja e kësaj pyetje është, jo. Kjo pasi si Bashkimi Evropian, si SHBA apo dhe OKB-ja kanë vendosur embargo armësh mbi Sudanin. Kjo nënkuption që çdo vend, anëtar i BE-së që është edhe anëtar i NATO-s detyrohet ligjërisht ta ndalojë transferimin e armëve nga Sudani për shkak të sanksioneve dhe ndalimit që është vendosur.

Aktualisht janë 3 embargo që nuk lejojnë eksportin e armëve nga Sudani. Embargo i OKB-së që mbulon pjesërisht Sudanin, embargo e BE-së si dhe embargo e SHBA-së që ndalojnë komplet eksportin e armëve apo mjeteve ushtarake nga Sudani.

**Po NATO çfarë thotë?**

NATO vetë nuk ka një mekanizëm të pavarur sanksionesh ekonomikë apo embargoje armësh të ngjashëm me atë të BE-së ose OKB-së. Kjo pasi NATO është një aleancë politike dhe ushtarake, e cila mund të koordinojë qëndrime politike dhe të ndajë informacione mes vendeve anëtare, por nuk është autoriteti që lëshon apo anulon licencat kombëtare të eksportit të armëve.

Kjo do të thotë se vendimi konkret merret nga vetë shtetet anëtarë të NATO-së, përfshi dhe Shqipërinë. Në rastin e vendit tonë, roli vendimtar i takon institucioneve shqiptare dhe kuadrit ligjor shqiptar. Nëse bëhet fjalë për një shtet apo subjekt ndaj të cilit ekzistojnë masa ndërkombëtare kufizuese, këto masa duhet të merren parasysh gjatë procesit të licencimit dhe kontrollit.

**Çfarë thotë ligji shqiptar?**

Kuadri shqiptar për kontrollin e transferimit të mallrave ushtarake dhe produkteve me përdorim të dyfishtë parashikon procedura të posaçme licencimi dhe vlerësimi të riskut. Ligji nr. 46/2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë" parashikon që një transferim mund të refuzohet kur ekzistojnë rreziqe që lidhen me sigurinë kombëtare, konfliktet e armatosura, respektimin e të drejtave të njeriut, stabilitetin rajonal, sanksionet dhe mundësinë e devijimit apo rieksportit të mallrave.

Pra, nuk mjafton që një kompani të deklarojë se një armë është blerë apo shitur për një qëllim të ligjshëm. Autoritetet shqiptare duhet të verifikojnë edhe origjinën e mallit, destinacionin, përdoruesin përfundimtar dhe rrezikun që paraqet transaksioni. Ligji parashikon gjithashtu raste kur një subjekt nuk mund të pajiset me certifikim, ndërsa informacioni i rremë, dokumentacioni i pasaktë apo dyshimet e arsyeshme për përfshirje në veprimtari të paligjshme mund të bëhen pengesë për regjistrimin dhe licencimin.

Nëse një kompani shqiptare do të merrte armë apo pajisje ushtarake nga një subjekt i sanksionuar, transaksioni do të kërkonte një verifikim shumë më të thelluar të ligjshmërisë së tij. Në varësi të subjektit furnizues, llojit të mallit dhe mënyrës së transferimit, mund të aktivizohen njëkohësisht rregulla të ndryshme të kontrollit dhe sanksioneve.

**Si e mori certifikatën Timak Defence nga shteti shqiptar?**

Kompania Timak Defence e Ron Yeffet ka marrë certifikatë nga shteti shqiptar në lidhje me eksportimin e armëve, por mënyra se si e ka marrë këtë mbetet e pa qartë. Kjo për shkak se shumë shtete e kanë sanksionuar Ron Yeffet për lidhje me kompaninë e armëve ELBI SYSTEM, e cila është nën hetim nga shumë vende të NATO-së për lidhje me bashkëpunimin me qarqe ruse. Ndërkohë që shumë biznesmenë të ndryshëm e akuzojnë Yeffet për mashtrim. Dhe vetëm me këto akuza dhe pretendime që janë publike, Yeffet nuk mund të merrte një certifikatë për tregti armësh nga shteti shqiptar. Por afërsia me kryeministrin Rama mesa duket ka qenë 'thembra e Akilit' e Yeffet, në mënyrë që të ketë nën kontroll kompaninë shqiptare që merret me tregtinë e armëve.

Disa nga pyetjet që presin përgjigje nga shteti shqiptar mbi përgjimin e Ron Yeffet janë: Cila kompani sudaneze

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 09:42

Dosja "Revanshi", GJKKO shpall vendimin/ Durim Bami dënohet me 10 vite e 8 muaj burg, ja sa u dënuan anëtarët e tjerë

## më të klikuarat

Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

"Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Ilir Meta del nga kafazi/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojë krah avokatit

## insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

## Moti

Powered by tomorrow.io

ishte furnizuese? A ishte ajo nën sanksione? A e ka KAYO licencën përkatëse për këtë transferim? Çfarë kontrolli është bërë për origjinën e armëve dhe përdoruesin përfundimtar? A i ka marrë autoriteti shqiptar këto të dhëna përpara se të autorizonte aktivitetin? Nëse këto pretendime konfirmohen, atëherë mbetet për tu sqaruar nëse furnizimi është kryer në përputhje me ligjin shqiptar dhe rregullat ndërkombëtare.**/Dosja.al**

ron yeffet arben ahmetaj timak defence kayo

## Sondazh

Poll

Politike

15 Shtator 2026, 12:19

# Kërkoi zëvendësimin e masës së sigurisë/ GJKKO rrëzon kërkesën e Ilir Metës, ish-presidenti mbetet në burg

Ilir Meta TIRANA- GJKKO ka rrëzuar kërkesën e ish-presidenti të vendit Ilir Meta i cili këkrkoi zbutje të masës së ...

### Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

Politike

15 Shtator 2026, 12:08

### Pagat e magjistratëve, Bardhi: Vendimin e GJK s'mund ta adresojnë as deputetët as punonjësit e administratës

Politike

15 Shtator 2026, 11:30

### Veliaj mbetet në burg, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e kryebashkiakut

Politike

15 Shtator 2026, 11:06

### Qeveria e Ramës i dha 4 mln euro nga fondi i emergjencave/ Der Spiegel: Kanye West pritet të performojë në Rusi, si po e përdor Kremlini për të rekrutuar njerëz në luftë

Politike

15 Shtator 2026, 10:46

Politike

15 Shtator 2026, 10:11

## Seanca për Erion Veliajn/ Trupa e Gjykatës së Lartë futet në Dhomën e Këshillimit për çështjen e kryebashkiakut

Erion Veliaj TIRANA- Seanca gjyqësore ndaj Erjon Veliaj pritet të nis për pak minuta në Gjykatën e Lartë. Gjyqtarë...

### Mbi 50 mijë euro për ndihmësit e deputetëve/ REL: Sa do t'i kushtojnë buxhetit të Kosovës asistentët e deputetëve?

Politike

15 Shtator 2026, 08:10

### Gjykata Kushtetuese tha se arresti i tij ishte jo proporcional/ Gjykata e Lartë shqyrton sot masën e sigurisë ndaj Erion Veliajt

Politike

15 Shtator 2026, 07:58

### Audiopërgjimi zbardh skemën si Roni Yeffet instrukton ukrainasit: Shkoni në Vlorë dhe thoni se përfaqësoni një kompani amerikane

Politike

14 Shtator 2026, 22:03

### Dhunuan me grusht qytetarin gjatë



arrestimit, Taulant Balla i del në mbrojtje
Policisë: Bën detyrën e tyre

Politike

14 Shtator 2026, 21:49

MË SHUMË

Daja i deputetes Zegjine

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.